

Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Shkurt, 2017


Tiranë, më 23 Mars 2017: Numri i shtetasve shqiptarë dhe të huaj të hyrë në territorin shqiptar, në muajin Shkurt 2017 është 464.485. Krahasuar me Shkurt 2016, ky tregues rezulton me rritje 3,6 %. Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vend është 185.721. Krahasuar me Shkurt 2016, ky numër është rritur me 9,5 %.

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vendin tonë, në dy muajt e parë 2017 është rritur 4,5 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2016.

Shtetasit shqiptarë dhe të huaj të dalë nga vendi gjatë muajit Shkurt 2017 janë 481.613, duke shënuar një rritje me 2,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Shkurt 2017 është 297.279. Krahasuar me Shkurt 2016 ky numër është rritur 0,7 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i vendit tonë në dy muajt e parë 2017 është ulur 0,4 %, krahasuar me njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig. 1 Hyrje-daljet e shtetasve në Shqipëri, Shkurt 2017



Për publikim 23/02/2017

Tab.1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj, Shkurt 2017

Periudha	Shk.-16	Shk.-17	Ndryshimi vjetor (%)	Jan.-Shk. 16	Jan.-Shk. 17	Ndryshimi vjetor progresiv (%)
Hyrje Gjithsej	448.234	464.485	3,6	914.046	932.647	2,0
Shqiptarë	278.678	278.764	0,3	570.956	574.169	0,6
Të Huaj	169.556	185.721	9,5	343.090	358.478	4,5
Dalje Gjithsej	472.378	481.613	2,0	1.053.462	1.039.722	-1,3
Shqiptarë	295.172	297.279	0,7	671.076	668.320	-0,4
Të Huaj	177.206	184.334	4,0	382.386	371.402	-2,9

Numri i vizitorëve të huaj, të hyrë në Shqipëri për qëllime pushimi dhe vizita ditore, në muajin Shkurt 2017 rezulton 35.096, ndërsa në Shkurt 2016 ky numër ishte 17.768.

Në Shqipëri, numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë për qëllime personale në Shkurt 2017 është 182.010 dhe përbën 98,0 % të numrit gjithsej të hyrjeve të shtetasve të huaj. Krahasuar me Shkurt 2016, numri i shtetasve të huaj për qëllime personale është rritur 9,8 %.

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në Shqipëri për qëllime biznesi përbën 0,2 % të hyrjeve të shtetasve të huaj, duke shënuar ulje me 3,4 %.

Tab.2 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit, Shkurt 2017

Periudha	Shk.-16	Shk.-17	Jan.-Shk.16	Jan.-Shk.17
Hyrje Shtetas të Huaj	169.556	185.721	343.090	358.478
I. Personale	165.699	182.010	336.665	351.832
1. Pushime	15.676	30.652	29.985	48.269
2. Vizitë në miq e të afërm	880	709	2.202	1.235
3. Vizitë ditore	2.092	4.444	3.497	17.201
4. Trajtim shëndetësor	35	53	99	96
5. Qëllime fetare	98	45	176	71
6. Vizitorë të tjerë	140.055	139.452	279.815	269.697
7. Udhëtarë transit	6.863	6.655	20.891	15.263
II. Biznes dhe profesionale	3.857	3.711	6.425	6.646


Hyrjet e shtetasve të huaj, në rrugë tokësore zënë peshën më të madhe me 83,6 %, ndërsa hyrjet në rrugë ajrore dhe detare zënë respektivisht 13,5 % dhe 2,9 %.

Tab.3 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit, Shkurt 2017

Periudha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Shkurt-2016	63.736	21.066	363.432	62.705	21.351	388.322
Shkurt-2017	69.499	21.501	373.485	69.462	23.262	388.889
Ndryshimi vjetor (%)	9,0	2,1	2,8	10,8	9,0	0,1
Janar-Shkurt 2016	134.290	46.344	733.412	141.803	76.739	834.920
Janar-Shkurt 2017	159.936	43.922	728.789	172.362	78.391	788.969
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	19,1	-5,2	-0,6	21,6	2,2	-5,5

Numri më i madh i hyrjeve të shtetasve të huaj në vendin tonë, në muajin Shkurt rezulton nga vendet fqinje, si Kosova me 30,9 %, pasuar nga hyrjet e shtetasve të huaj nga Maqedonia me 15,9 %, Greqia me 15,0 %, Mali i Zi me 12,9 %, etj.

Fig. 2 Shtetet me hyrjet më të mëdha në Shqipëri



Metodologji

Përkufizime:

Vizitorë: Për qëllime të statistikës së turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimit në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Hyrjet : Përfshijnë të gjitha hyrjet në kufi.

Hyrjet është një koncept që i referohet të gjitha arritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re

Daljet : Përfshijnë të gjitha daljet në kufi. Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës.

Qëllimi kryesor i vizitës është qëllimi pa të cilën udhëtimi nuk do të kryhej. Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për arsye:

Vizitat për *qëllime personale*

1. Pushime
2. Vizitë në miq e të afërm
3. Vizitë ditore
4. Trajtim shëndetësor
5. Qëllime fetare
6. Vizitorë të tjerë
7. Udhëtarë tranzit

Kategoria e biznesit përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme (Drejtoria e Policisë së Shtetit).

Të dhënat e muajit të fundit janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/reth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/>